



Datë: 29.10.2025
Numër Protokolli: 7075/2025

A.nr.1301/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1301/2025, të datës 07.07.2025, të parashtruar nga ankuesja L.S, kundër organit të punësimit: Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike “*kundërshtim i masës disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1301/2025, e datës 07.07.2025, e parashtruar nga ankuesja L.S.

II. Mbetet në fuqi masa disiplinore “paralajmërim me shkrim” e shqiptuar ndaj ankuseses me datë 19.05.2025.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, L.S (*tutje referuar ankuesja*), përmes postës më datë 02.07.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar më datë 07.07.2025, dhe është identifikuar nën shenjën A.nr.1301/2025, kundër masës disiplinore “paralajmërim me shkrim” e shqiptuar më datë 04.06.2025 nga Udhëheqësi i Sektorit të Tatimit në Pronë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 14.07.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Prishtinës, ndërsa, kjo e fundit më datë 18.07.2025 ka përcjell shkresat ndërlidhur me çështjen ankimore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 4524/2025 të datës 07.07.2025 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Zarin e datës 02.07.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 14.07.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 18.07.2025; Akt Emërimit me Nr. 01-112-349 të datës 16.11.2024; Paralajmërimin me shkrim të datës 04.06.2025; Raportin e vijueshmërisë në punë të ankuese për muajin qershor 2025.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë së ankuesja është e punësuar në Komunën e Prishtinës. Dhe së e njëjta sipas Akt-it të Emërimit me Nr. 01-112-349 të datës 16.11.2024, ushtron pozitën *Zyrtare e Tatimit në Pronë* në kuadër të Drejtorisë së Financave.

Tutje sipas shkresave të lëndës del së Udhëheqësi i Sektorit të Tatimit në Pronë në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankueses, më datë 04.06.2025 ka shqiptuar ndaj ankueses masën disiplinore “paralajmërim me shkrim”, për shkelje të lehtë disiplinore “*mos respektim i orarit të punës, mbi arsyet se: Duke e parë se L.S edhe pas shumë vërejtjeve verbale të një pas njëshme e njëjta vazhdimisht mungon gjatë orarit të punës, pa paralajmërim dhe pa leje nga unë si mbikëqyrës. Dje, më datë 03.06.2025 rreth orën 09:00, kisha nevojë për konsultim lidhur me disa email-e zyrtare dhe nuk ishte ne vendin e punës, E njëjta gjë përsëritet edhe sot më datë 04.06.2025 rreth orës 9:20. Po ashtu tentova ta kontakton përmes telefonit por nuk u lajmërua...*”.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton masën disiplinore “paralajmërim me shkrim”, duke pretenduar së nuk qëndron fakti që nuk kam qenë në punë, sepse siç kam njoftuar shefin përmes emailit për disa minuta nuk kam qenë në zyrë por kam qenë në objektin e komunës. Masa disiplinore nuk ka bazë juridike sepse nuk është aplikuar neni 14 i Rregullores (QRK) Nr. 01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil. Kërkon të aprovet ankesa, të anulohet masa disiplinore e goditur më ankesë dhe e njëjta të largohet nga dosja personale.

Në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve të ankueses, Kolegji i Këshillit iu referua Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, me theks të veçantë:

-Nenit 55 paragrafi 1: “Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim”.

-Nenit 56, paragrafi 1: “Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. 3. Shkelje të lehta konsiderohen: 3.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune radhazi; **3.2. mosrespektimi i orarit të punës;** 3.3. sjellja jo e mirë gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit/it, koleget/ët, vartëset/it dhe me publikun.

-Nenit 57: 1. Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunës/it civil për shkelje të lehta janë: 1.1. vërejtje verbale; **1.2. paralajmërim me shkrim;** 1.3. vërejtje me shkrim. 2. Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunës/it civil për shkelje të rënda janë: 2.1. ndalimi nga njëzet për qind (20%) deri në pesëdhjetë (50%) e pagës bazë për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj; 2.2. ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë nga një (1) deri në pesë (5) vite; 2.3. transferimi në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë; 2.4. ulja në pozitë; 2.5. pezullimi nga pozita pa pagesë deri në gjashtë (6) muaj; 2.6. pezullimi nga pozita me ndalim deri në pesëdhjetë për qind (50%) të pagës bazë, deri në një (1) vit; 2.7. largimi nga shërbimi civil.

-Nenit 58, paragrafi 1 dhe 2: **1. Masat disiplinore për shkeljet e lehta shqiptohen nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe/apo nga udhëheqësja/i më i lartë administrativ.** 2. Masat disiplinore për shkeljet e rënda shqiptohen nga komisioni disiplinor.

-Nenit 61 paragrafi ku përcaktohet: 1. Për përcaktimin e masës disiplinore mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të

mëparshme të pashlyera, sipas nenit 62 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunës/it për shmangien apo kufizimin e dëmit.

Referuar kuadrit ligjor si më lartë, Kolegji ka analizuar aktin e kundërshtuar më ankesë në ndërlidhje edhe me provat tjera materiale të çështjes dhe si rrjedhojë konstaton së masa disiplinore e kundërshtuar më ankesë është shqiptuar nga organi kompetent dhe bazohet në vërtetim të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të drejtë të së drejtës materiale, sepse, edhe vet ankuesja ka pohuar në ankesë së nuk ka qenë në zyrë në datat kontestuese dhe se e njëjta me asnjë provë nuk argumenton prezencën e saj në objektin e komunës, përjashtimisht që deklaron se ka qenë në objektin e komunës duke mos specifikuar ku dhe pse.

Ne fakt, duke qenë së orari i punës dhe prezenca në punë janë detyrime të çdo zyrtari publik, Kolegji i Këshillit i'u referua Rregullores në fuqi (QRK) Nr.04/2024 për Orarin e Punës, Pushimet dhe Vijueshmërinë e Zyrtarëve Publik, respektivisht, nenit 4 dhe 16, ku përcaktohet: 4. 1. *Orari i punës nënkupton periudhën kohore, gjatë së cilës zyrtari publik kryen punë ose shërbime në të mirë të institucioni.* 4.2. *Orari i punës së zyrtarëve publik fillon në orën 08:00 dhe përfundon në orën 16:00, pesë (5) ditë në javë duke filluar nga e hëna deri të premten, përveç nëse caktohet ndryshe nga institucioni përkatës për shkak të natyrës së punës.* 16. *Gjatë orarit të punës zyrtari publik është i obliguar të jetë prezent në vendin e punës...* andaj, nisur nga ky përcaktim ligjor dhe meqenëse asnjëra nga palët në procedura nuk ka prezantuar dëshmi që vërteton së Komuna e Prishtinës ka të miratuar orar zyrtar tjetër të punës nga ai i përcaktuar me rregullore, atëherë, rezulton fakti se në këtë institucion aplikohet orari i punës 08:00 me 16:00. E në këtë kontekst, Kolegji bazuar edhe në regjistrimet e vijueshmërisë në punë të ankueses për datat kontestuese ka gjetur së ankuesja në datën 03.06.2025, ka regjistruar hyrjen në punë në orën 08:30, ndërsa, ka regjistruar dalje nga puna në orën 15:29, kurse, për datën 04.06.2025, e njëjta është evidentuar sipas sistemit të vijueshmërisë në orën 08:32, ndërsa, daljen nga puna e ka bërë në orën 15:42, pra, ankuesja nuk ka regjistrim të rregullt të vijueshmërisë dhe sipas orarit të lejuar.

Përkitazi më pretendimin ankimor se në rastin konkret nuk është aplikuar neni 14 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil, Kolegji i Këshillit vlerëson së në çështjen disiplinore janë marr parasysh rrethanat e kryerjes, pasojat e veprimit si dhe shkalla e fajësisë siç përcaktohet me nenin 14 paragrafi 1 të kësaj rregullore ku parashihet se: *Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pa fshira; 1.4. Përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit.*

Kolegji i Këshilli bazuar në të gjeturat dhe konstatimet si me sipër, vlerëson se në veprimet e ankueses manifestohen elementet e shkeljes së lehtë disiplinore ” mosrespektimi i orarit të punës” , andaj, edhe masa e shqiptuar disiplinore është në proporcion më përgjegjësinë e ankueses, kështu që, Kolegji duke bazuar në nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/8L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të vendimit, rrjedhimisht refuzoj ankesën si të bazuar dhe la në fuqi si të ligjshëm aktin e kontestuar më ankesë.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda :A.nr.1301/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses L.S;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.